# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**
**www.legjislacionishqiptar.gov.al**

| Nr.6 | 8 shkurt | 2006 |
|---|---|---|

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr.9465 datë 19.1.2006 | Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Çeke për zgjidhjen e borxhit të Shqipërisë kundrejt Republikës Çeke"……………………………………….. | 99 |
| Dekret nr.4763 datë 6.2.2006 | Për lirim ambasadori………………………………………………. | 103 |
| Vendim i KM nr.59, datë 1.2.2006 | Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të një pjese të objektit të ish-ndërtesës së spitalit civil, Shkodër, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Arsimit dhe e Shkencës…………………………………………………… …….. | 104 |
| Vendim i KM nr.60, datë 1.2.2006 | Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror……. | 108 |
| Vendim i KKRT nr.414, datë 23.1.2006 | Mbi pavlefshmërinë e licencës së disa subjekteve radiotelevizive private……………………………………………… | 122 |

**L I G J**
**Nr.9465, datë 19.1.2006**

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ÇEKE PËR ZGJIDHJEN E BORXHIT TË SHQIPËRISË KUNDREJT REPUBLIKËS ÇEKE"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja "ç" të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Çeke për zgjidhjen e borxhit të Shqipërisë kundrejt Republikës Çeke".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4762, datë 2.2.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE**
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS ÇEKE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZGJIDHJEN E BORXHIT TË SHQIPËRISË KUNDREJT REPUBLIKËS ÇEKE

Qeveria e Republikës Çeke dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë (më poshtë "Palët Kontraktuese"),

*mbështetur* në protokollin ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale Çeke e Sllovake dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë mbi zgjidhjen e të ardhurave dhe detyrimeve reciproke në kuadrin e marrëdhënieve ekzistuese të pagesave deri më 31 dhjetor 1991, nënshkruar në Tiranë më 23 janar 1992,

*duke marrë* parasysh notën nr.100.589/94-MPO të datës 29.7.1994 të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Çeke drejtuar Ambasadës së Republikës të Shqipërisë në Pragë, mbi ndarjen ndërmjet Republikës Sllovake dhe Republikës Çeke të të ardhurave dhe detyrimeve të ish- Republikës Federale Çeke e Sllovake kundrejt vendeve të tjera,

*duke respektuar* faktin që Republika Çeke si një nga dy pasardhësit ligjorë të ish-Republikës Federale Çeke e Sllovake, administron vetë në mënyrë të pavarur pjesën e saj të të ardhurave dhe detyrimeve të ish-Republikës Federale Çeke e Sllovake,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1.1 Borxhi i Republikës së Shqipërisë kundrejt ish-Republikës Federale Çeke e Sllovake

rrjedh nga marrëveshja tregtare ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale Çeke e Sllovake dhe Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të 26 tetorit 1990, zëvendësuar pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë, nga protokolli ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale Çeke e Sllovake dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë mbi zgjidhjen e të ardhurave dhe detyrimeve reciproke në kuadrin e marrëdhënieve ekzistuese të pagesave deri më 31.12.1991, nënshkruar në Tiranë më 23 janar 1992.

1.2 Borxhi i Republikës së Shqipërisë kundrejt ish-Republikës Federale Çeke e Sllovake sipas gjendjes më 31 dhjetor 2004, për të cilin Palët Kontraktuese kanë rënë dakord, përbëhet nga:

1.2.1 Principali në rubla klering në shumën prej 471 348.99 RBL Clg, mbajtur në llogarinë likuiduese nr. 51 008 053 me Cekoslovenská Obchodní banka, a.s.Prage, nga e cila pjesa e Republikës Çeke përfaqëson 314 232.66 RBL Clg.

1.2.2 Shuma në dollarë klering mbajtur në llogarinë likuiduese nr.51008000 me Cekoslovenská Obchodní banka, a.s. Prage, që përbëhet nga principali në shumën 15 039 622.15 USD Clg dhe interesi prej 3 309 442.62 USD Clg. Pjesa e Republikës Çeke përbëhet nga 10 026 414.77 USD Clg principal dhe 2 206 295.08 USD Clg interes.

Neni 2

Për konvertimin e monedhave klering në dollarë lirisht të këmbyeshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (më poshtë referuar USD), Palët Kontraktuese konfirmojnë kurset e këmbimit si më poshtë:

3.30 RBL Clg=1.00 USD 1.00 USD Clg=1.00 USD

Neni 3

3.1 Borxhi në RBL Clg dhe USD Clg i Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës Çeke, përcaktuar në nenin 1.2.1 dhe 1.2.2 të kësaj Marrëveshjeje, do të konvertohet në USD duke përdorur kurset e këmbimit të theksuara në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

3.2 Borxhi i Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës Çeke, i konvertuar në USD, përfaqësohet nga:

a) principali prej 95 222.02 USD, i cili rrjedh nga llogaria likuiduese nr.51 008 053;

b) principali prej 10 026 414.77 USD, i cili rrjedh nga llogaria likuiduese nr.51 008 000;

c) interesi prej 2 206 295.08 USD, i cili rrjedh nga llogaria likuiduese nr.51 008 000.

Neni 4

Palët Kontraktuese kanë rënë dakord për termat dhe kushtet e mëposhtme për zgjidhjen e borxhit të Shqipërisë kundrejt Republikës Çeke:

4.1 Interesi i përcaktuar në nenin 3.2 pika C të kësaj Marrëveshjeje, në shumën prej 2 206 295.08 USD, do të falet.

4.2 Borxhi i Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës Çeke, i përcaktuar në nenin 3.2 pika a dhe pika b të kësaj Marrëveshjeje, në shumën prej 10 121 636.79 USD, do të paguhet në dhjetë këste të barabarta vjetore. Afati i detajuar i pagesës së principalit është dhënë në shtojcën nr.1, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

4.3 Mbi balancën e papaguar të borxhit të përcaktuar në nenin 4.2 të kësaj Marrëveshjeje do të paguhet interes në masën 1.75% në vit (një vit do të konsiderohet i barabartë 360/360 ditë). Llogaritja e interesit do të fillojë nga data e bërjes efektive të kësaj Marrëveshjeje. Periudha e parë e llogaritjes së interesit do të jetë nga data e bërjes efektive të kësaj Marrëveshjeje deri më 30.10.2005, duke e përfshirë këtë datë. Periudhat e mëpasshme të llogaritjes së interesit janë nga 31 tetori i vitit aktual deri më 30 tetor të vitit pasardhës. Afati i detajuar i pagesës së interesit është dhënë në shtojcën nr.1, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

4.4 Pagesat e interesit do të kryhen së bashku me pagesat e principalit më 31 tetor, duke filluar nga 31 tetori 2005 dhe duke përfunduar më 31 tetor 2014, me përjashtim të rastit të specifikuar në nenin 5.6.

4.5 Në rast se ndonjë nga pagesat e principalit të përcaktuara në nenin 4.2 ose ndonjë nga

pagesat e interesit të llogaritur në përputhje me nenin 4.3 të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të paguhen në shumën apo datën e përcaktuar në shtojcën nr.1 të Marrëveshjes, Palët Kontraktuese bien dakord për zbatimin e interesvonesave në masën 4%, të cilat do të llogariten nga dita pasuese e datës së maturimit të këstit përkatës deri në datën e pagesës së tij, me përjashtim të rastit të specifikuar në nenin 5.6.

4.6 Interesvonesat, të përcaktuara në nenin 4.5 të kësaj Marrëveshjeje, duhen paguar brenda 30 ditëve kalendarike nga data e pagesës së principalit, të përcaktuar në nenin 4.2 ose të interesit, të përcaktuar në nenin 4.3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

5.1 Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë për palën shqiptare dhe Cekoslovenská Obchodní banka, a.s. për palën çeke, janë përgjegjëse për zbatimin teknik të kësaj Marrëveshjeje.

5.2 Për mbajtjen e regjistrimeve të borxhit të riskeduluar, Cekoslovenská Obchodní banka, a.s. (më poshtë referuar si "CSOB") do të hapë në librat e saj, në emër të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, llogarinë e riafatimit nr.51 008 010 në USD lirisht të këmbyeshëm. Brenda 15 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, CSOB do t'i transferojë shumat respektive të konvertuara të borxhit, në përputhje me nenin 4.2 të kësaj Marrëveshjeje, nga llogaritë likuiduese të kleringut mbajtur nga CSOB në RBL Clg dhe USD Clg, në debi të llogarisë së riafatimit. Shuma e interesit, e përcaktuar në nenin 4.1 të kësaj Marrëveshjeje, do të fshihet nga librat e CSOB më 1 janar 2006.

5.3 Mbi balancën debitore të papaguar të llogarisë së riafatimit do të paguhet interes në masën 1.75% në vit, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Shumat e interesit, të llogaritura në përputhje me shtojcën nr.1 të kësaj Marrëveshjeje, do të regjistrohen nga CSOB në debi të llogarisë së riafatimit gjithmonë më 31 tetor të çdo viti ose në ditën pasardhëse të punës në rast se në këtë datë bankat janë të mbyllura. CSOB do të njoftojë Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë për shumën e këstit të parë të interesit që duhet paguar më 31 tetor 2005.

5.4 Këstet e paguara të principalit dhe interesit do të regjistrohen nga CSOB në kredi të llogarisë së riafatimit duke përdorur datë-valutat faktike të pagesave të kryera në llogarinë nr.118 30 301 të CSOB me KBC Bank N.V. New York Branch. CSOB do të konfirmojë pagesën e çdo kësti dhe do t'i dërgojë Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë pasqyrat respektive të gjendjes së llogarisë së riafatimit.

5.5 Në rast të ndonjë vonese në pagesën e principalit ose të intersit, do të llogariten interes-vonesat në masën 4% në vit. Interesvonesat do të llogariten nga CSOB mbi bazën e balancës ditore të llogarisë së riafatimit, mbi bazën e vitit 360/360 ditë duke filluar nga data pasuese e datës së maturimit të këstit përkatës deri në datën e pagesës faktike të tij.

5.6 Në qoftë se marrëveshja nuk do të jetë efektive më 31 tetor 2005, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do të paguajë këstin e parë të principalit menjëherë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes dhe në këtë rast nuk do të zbatohen interes-vonesa. Shuma e këstit të dytë të interesit të rregullt që duhet paguar më 31 tetor 2006 nuk do të pakësohet dhe do të paguhet në përputhje me shtojcën nr.1 të Marrëveshjes.

5.7 Pala shqiptare do të paguajë çdo këst të principalit sipas nenit 4.2, çdo këst të interesit nga balanca e papaguar e borxhit sipas nenit 4.3 dhe, në rast se do të ketë, interesvonesat sipas nenit 4.5 dhe 4.6 të nenit 4, pa bërë asnjë zbritje për komisione bankare apo shpenzime të tjera, në favor të Ministrisë së Financave të Republikës Çeke me mjetet e Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, në llogarinë nr.118 30 301 të CSOB me KBC Bank N.V. New York Branch (Swift Address: Kredus 33) duke njoftuar dy ditë më parë CSOB me fax/e-mail për këtë qëllim.

Neni 6

6.1 Palët Kontraktuese do të njoftojnë me shkrim njëra-tjetrën mbi përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën më të fundit të këtyre njoftimeve reciproke.

6.2 Vlefshmëria e protokollit të nënshkruar më 23 janar 1992 në Tiranë ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale Çeke e Sllovake dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë mbi rregullimin e të

ardhurave dhe detyrimeve dypalëshe në kuadrin e marrëdhënieve të pagesave sipas gjendjes më 31 dhjetor 1991, do të përfundojë në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

6.3 Kjo Marrëveshje do të mbetet e vlefshme deri në pagesën e plotë të késteve të përcaktuara në nenin 4.2, 4.3 dhe 4.5 të kësaj Marrëveshjeje.

6.4 Marrëveshja mund të ndryshohet apo plotësohet mbi bazën e një marrëveshjeje dypalëshe ndërmjet Palëve Kontraktuese. Ndryshimet dhe plotësimet e Marrëveshjes duhet të jenë në formë të shkruar.

6.5 Në qoftë se gjatë zbatimit të Marrëveshjes do të ketë mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese, këto mosmarrëveshje do të zgjidhen në rrugë diplomatike në formën e konsultimeve dypalëshe ndërmjet përfaqësuesve të Ministrisë së Financave të Republikës Çeke dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë.

6.6 Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese mund t'i drejtohen njëra-tjetrës në këto adresa:

The Ministry of Finance of the Republic of Albania
Attn: Debt. Departament
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", No.1, Tirana, Albania
Fax: ++ (355 4) 228494
++ (355 4) 258435

The Ministry of Finance of the Czech Republic
Attn: International Finance Departament
Letencká 15, 118 10 Praha 1, Czech Republic
Tel: ++ 420 257042296
Fax: ++ 420  257042407

Cekoslovenská Obchodní banka, a.s.
Attn: Government Assets Administration Departament
Na Príkope 854/14, 115 20 Praha 1, Czech Republic
Fax: ++420 261357580

Bërë në__  më____në dy origjinale në gjuhën angleze.

Shtojca nr.1
Afati i ripagimit të borxhit të Shqipërisë kundrejt Republikës Çeke

| Këstet | Principali (në USD) | Interesi (USD) | Data e maturimit të kësteve (principal +interes) |
|---|---|---|---|
| 1. | 1 012 163.68 | Në përputhje me nenin 4.3 | 31.10.2005 |
| 2. | 1 012 163.68 | 159 415.78 | 31.10.2006 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 3. | 1 012 163.68 | 141 702.92 | 31.10.2007 |
| 4. | 1 012 163.68 | 123 990.05 | 31.10.2008 |
| 5. | 1 012 163.68 | 106 277.19 | 31.10.2009 |
| 6. | 1 012 163.68 | 88 564.32 | 31.10.2010 |
| 7. | 1 012 163.68 | 70 851.46 | 31.10.2011 |
| 8. | 1 012 163.68 | 53 138.59 | 31.10.2012 |
| 9. | 1 012 163.68 | 35 425.73 | 31.10.2013 |
| 10. | 1 012 163.68 | 17 712.86 | 31.10.2014 |
| Gjithsej | 10 121 636.79 | 797 078.90 + këstin e interesit të pagueshëm me 31.10.2005 | |

**DEKRET**
**Nr.4763, datë 6.2.2006**

**PËR LIRIM AMBASADORI**

Në mbështetje të nenit 92 pika dh të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Leonidha Mërtiri lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Rumanisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Alfred Moisiu**

**VENDIM**
**Nr.59, datë 1.2.2006**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË NJË PJESE TË OBJEKTIT TË ISH-NDËRTESËS SË SPITALIT CIVIL, SHKODËR, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, të një pjese të objektit të ish-ndërtesës së spitalit civil, Shkodër, përkatësisht katin e parë dhe të dytin, të përcaktuar në formularin nr.3, sipas planvendosjes dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për Universitetin e Shkodrës.

2. Universitetit të Shkodrës i ndalohet të ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve këtë pronë.

3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Arsimit dhe i Shkencës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**




TIP
SHK. 1:100
770
W/C
2.35
2.32
330
3.20
2.30
6.50
2.45
4.20
3.50
3.39
2.32
3.16
4.30
5.70
1049
1002
S.P.A.
STUDIO PROJEKTIMI
ARBEN PEJO.
VEPRA.
SPITALI CIVIL
SHKODER (RILEVIM)
EMERTIMI
PLANI KATI TIP
H/S

## 3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

| Institucioni i Pushtetit Qendror: Ministria e Shëndetësisë<br>Bashkia Shkodër<br>Fusha e përdorimit të pronës: Shëndetësi | | | | | | | Identifikoi:Donard Stermasi-Shef i Sektorit të Investimeve<br>Supervizoi________________________<br>Aprovoi: Durim Kraja-Drejtor i Drejtorisë Ekonomike | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
| | **Zona kadastr. &indeksi i Hartës** | **Nr.i pasurisë** | **Emërtesa e pronës Vendododhja/Shtrirja gjeografike** | **Komponentët përbërës të pronës** | **Adresa/Vendndodhje e komponentëve përbërës të pronës** | **Përmasat e pronës në ($m^2$)** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Insitucioni/Enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/Enti përdorues,Statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)** |
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** | **11** |
| | | | Spitali Rajonal Shkodër | Urgjenca+ Sallat operac | Brenda territorit | 3196 | Shërb. mjekësor | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | " " " | Rep Kirurgjisë | Brenda territorit | 256 | Shërb. mjekësor | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | " " " | Materniteti | Brenda territorit | 1357 | Shërb. mjekësor | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | " " " | Muri rrethues | Brenda territorit | 677 | Shërb.ndihmës | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | " " " | Vendroja | Brenda territorit | 23 | Shërb.ndihmës | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | Sanatoriumi Shkodër | Godina | | 450 | Shërb. mjekësor | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | " " " | Muri rrethues | Brenda territorit | 293 | Shërb.ndihmës | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | " " " | Trualli | Brenda territorit | 4160 | Shërb.ndihmës | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | Spitali Infektiv Shkodër | Godina | | 716 | Shërb. mjekësor | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | " " " | Muri rrethues+Vendroja | Brenda territorit | 318 | Shërb.ndihmës | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | " " " | Trualli | Brenda territorit | 5510 | Shërb.ndihmës | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | Spitali Pediatrik Shkodër | Godina | | 1180 | Shërb. mjekësor | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | " " " | Domat e nënave | Brenda territorit | 292 | Shërb.ndihmës | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | Poliklin. Qendër Shkodër | Godina | Qendër qyteti | 590 | Shërb. mjekësor | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | " " " | Trualli | Qendër qyteti | 1457 | Shërb.ndihmës | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | Poliklin. L.Dergut Shkodër | Godina | Lagjja Dergut | | Shërb. mjekësor | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | Spitali Psikiatrik Shkodër | Godina | | 1100 | Shërb. mjekësor | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | " " " | Garazh+Rep.ma | Brenda territorit | 70 | Shërb.ndihmës | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | rangoz | | | | | | |
| | | | Spitali Civil Shkodër | Godina e pavionëve | Brenda territorit | 1021 | Shërb. mjekësor | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | “ “ “ | Rep.pranimit | Brenda territorit | 110 | Shërb. mjekësor | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | “ “ “ | Lavanderia+marangnozi | Brenda territorit | 1085 | Shërb.ndihmës | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | “ “ “ | Garazhet | Brenda territorit | 152 | Shërb.ndihmës | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | “ “ “ | Rrethimi+Trualli | Brenda territorit | 8297 | Shërb.ndihmës | Drejt.Spitaleve | Drejt.Spitaleve | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

**VENDIM**
**Nr.60, datë 1.2.2006**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Lista përbëhet nga 14 (katërmbëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

1.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

| Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale<br>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror<br><br>Bashkia Tiranë<br><br>Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale | | | | | | | Identifikoi: Ing.Bujar Bundo<br>(Specialist investimesh)<br><br>Supervizoi: Edmond Kushi<br>(Shef shërbimesh)<br><br>Aprovoi: Natasha Hodaj<br>(Drejtor i Përgjithshëm) | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. rendor** | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
| | **Zona kadastr. &Indeksi i hartës** | **Nr.i pasurisë** | **Lloji i pronës** | **Emri i pronës adresa** | **Sip.totale e pronës ($m^2$)** | **Nga sip. totale: sa e ndërtesës ($m^2$)** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Insitucioni/enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/enti përdorues,statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)** |
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** | **11** |
| 1 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina administrative e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror Rr.Durrësit, nr.83 Tiranë | 1706 | 402 | Zyra administrative | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Ndërtesë 3- katëshe |
| 2 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e Qendrës së Zhvillimit Tiranë | 3100 | 588 | Qendër shërbimesh me PAK | MPÇS Dr.Përgjithshme SHSSH | Drejtoria e Qendrës së Zhvillimit | Ndërtesë 2-katëshe |
| 3 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e Qendrës Ditore Polivalente për Shërbime Sociale Kamëz | 5380 | 1423 | Qendër ditore shërbimesh për të moshuarit | MPÇS Dr.Përgjithshme SHSSH | Drejtoria e Qendrës Ditore | Ndërtesë 3-kate&1 kate |
| 4 | | | Ndërtesë | Godina administrative e Zyrës Rajonale | 100 | 100 | Zyrë administrative | MPÇS Dr.Përgjithshme SHSSH | Drejtoria e Qendrës | Kati përdhe pallat 5-katësh |
| 5 | | | Truall | Godina e shtëpisë | 750 | 310 | Qendër | MPÇS | Drejtoria e | Ndërtesë |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Ndërtesë | së të moshuarve Tiranë | | | rezidenciale shërbimesh për të moshuarit | Dr.Përgjith SHSSH | qendrës për të moshuarit | 2-katëshe |
| 6 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e shtëpisë së fëmijëve 6-14 vjeç Tiranë | 7400 | 1537 | Qendër shërbimesh për fëmijët shkollorë | MPÇS Dr.Përgjith SHSSH | Drejtoria e Qendrës | Ndërtesë 3 kate &4 kate |
| 7 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e fëmijëve jetimë mbi 14 vjeç Tiranë | 930 | 840 | Qendër rezidenciale shërbimesh për fëmijët mbi 14 vjeç | MPÇS Dr.Përgjith SHSSH | Drejtoria e Qendrës | Ndërtesë njëkatëshe |

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

| | |
|---|---|
| Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës dhe e | Identifikoi: Ing.Bujar Bundo |

| | |
|---|---|
| Çështjeve Sociale<br>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror<br><br>Bashkia Shkodër<br><br>Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale | (Specialist investimesh)<br><br>Supervizoi: Edmond Kushi<br>(Shef Shërbimesh)<br><br>Aprovoi: Natasha Hodaj<br>(Drejtor i Përgjithshëm) |

| **Nr. rendor** | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Zona kadastr. &indeksi i hartës** | **Nr. i pasurisë** | **Lloji i pronës** | **Emri i pronës adresa** | **Sip.totale e pronës ($m^2$)** | **Nga sip. Totale: sa e ndërtesës ($m^2$)** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Insitucioni/Enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/Enti përdorues, Statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)** |
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** | **11** |
| 8 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e shtëpisë së foshnjës Shkodër | 885 | 310 | Qendër rezidenciale për foshnjat 0-3 vjeç | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e shtëpisë së foshnjës | Ndërtesë 2 -katëshe |
| 9 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e shtëpisë së fëmijës parashkollor 3-6 vjeç Shkodër | 2000 | 750 | Qendër rezidenciale për fëmijët 3-6 vjeç | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e shtëpisë | Ndërtesë 2-katëshe |
| 10 | 8592 | 3/69 | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e shtëpisë së fëmijëve shkollorë 6-14 vjeç Shkodër | 4262 | 1380 | Qendër rezidenciale shërbimesh për fëmijët shkollorë | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e shtëpisë së fëmijëve shkollorë | Ndërtesë 3-kate &1 katëshe |
| 11 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e shtëpisë së të moshuarve Shkodër | 2520 | 1010 | Qendër rezidenciale shërbimesh për të moshuarit | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e shtëpisë së të moshuarve | Ndërtesë 3-katëshe |
| 12 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e qendrës së zhvillimit rezidenciale, Shkodër | 4215 | 970 | Qendër rezidenciale shërbimesh për PAK | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e Qendrës së Zhvillimit | Ndërtesë 2-katëshe |
| 13 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e pushimit të fëmijëve Velipojë | 1150 | 380 | Qendër pushimesh për fëmijët jetimë | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e shtëpisë së fëmijëve shkollorë 6-14 vjeç | Ndërtesë 1-katëshe |

## 1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

| | |
|---|---|
| Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës dhe çështjeve Sociale | Identifikoi: Ing.Bujar Bundo<br>(Specialist investimesh) |

| | |
|---|---|
| Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror<br><br>Bashkia Lezhë<br><br>Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale | Supervizoi: Edmond Kushi<br>(Shef shërbimesh)<br><br>Aprovoi: Natasha Hodaj<br>(Drejtor i Përgjithshëm) |

| **Nr. rendor** | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Zona kadastr. &indeksi i hartës** | **Nr. i pasurisë** | **Lloji i pronës** | **Emri i pronës adresa** | **Sip.totale e pronës ($m^2$)** | **Nga sip. Totale: sa e ndërtesës ($m^2$)** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Insitucioni/enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)** |
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** | **11** |
| 14 | | | Ndërtesë | Godina e Qendrës Ditore Lezhë | 300 | 300 | Qendër ditore për PAK | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e Qendrës Ditore | Ndërtesë 4-katëshe |

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

| | |
|---|---|
| Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale<br>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Identifikoi: Ing.Bujar Bundo<br>(Specialist investimesh)<br><br>Supervizoi: Edmond Kushi |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Bashkia Durrës<br><br>Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale | | | | | | | (Shef shërbimesh)<br><br>Aprovoi: Natasha Hodaj<br>(Drejtor i Përgjithshëm) | | | |
| **Nr. rendor** | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
| | **Zona kadastr. & indeksi i hartës** | **Nr.i pasurisë** | **Lloji i pronës** | **Emri i pronës adresa** | **Sip.totale e pronës ($m^2$)** | **Nga sip. totale: sa e ndërtesës ($m^2$)** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Insitucioni/enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)** |
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** | **11** |
| 15 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e Qendrës së Zhvillimit Durrës | 2420 | 626 | Qendër rezidenciale për fëmijët me AK | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e Qendrës së Zhvillimit | Dy ndërtesa 2- katëshe |
| 16 | 8516 | 4/47 | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e shtëpisë së foshnjës 0-3 vjeç Durrës | 1755 | 724 | Qendër rezidenciale për foshnjat 0-3 vjeç | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e shtëpisë së foshnjës | Dy ndërtesa 2 kate & 3 kate dhe 1 kat |
| 17 | | | Ndërtesë | Godina e Zyrës Rajonale Durrës | 90 | 90 | Zyrë administrative | Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e Zyrës Rajonale | Kati përdhe, pallat 6-katësh |

## 1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

| | |
|---|---|
| Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale<br>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror<br><br>Bashkia Kavajë<br><br>Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale | Identifikoi: Ing.Bujar Bundo<br>(Specialist investimesh)<br><br>Supervizoi: Edmond Kushi<br>(Shef shërbimesh)<br><br>Aprovoi: Natasha Hodaj |

| (Drejtor i Përgjithshëm) | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. rendor** | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
| | **Zona kadastr. &indeksi i hartës** | **Nr.i pasurisë** | **Lloji i pronës** | **Emri i pronës adresa** | **Sip.totale e pronës ($m^2$)** | **Nga sip. totale: sa e ndërtesës ($m^2$)** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Insitucioni/enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)** |
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** | **11** |
| 18 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e shtëpisë së të moshuarve Kavajë | 3378 | 720 | Qendër shërbimesh për të moshuarit | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e shtëpisë së të moshuarve | Ndërtesë<br>2- katëshe |

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

| | |
|---|---|
| Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale<br>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror<br><br>Bashkia Fier<br><br>Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale | Identifikoi: Ing.Bujar Bundo<br>(Specialist investimesh)<br><br>Supervizoi: Edmond Kushi<br>(Shef shërbimesh)<br><br>Aprovoi: Natasha Hodaj |

| (Drejtor i Përgjithshëm) | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. rendor** | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
| | **Zona kadastr. &indeksi i hartës** | **Nr.i pasurisë** | **Lloji i pronës** | **Emri i pronës adresa** | **Sip.totale e pronës ($m^2$)** | **Nga sip. totale: sa e ndërtesës ($m^2$)** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Insitucioni/enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)** |
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** | **11** |
| 19 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e shtëpisë së të moshuarve Fier | 1800 | 770 | Qendër shërbimesh për të moshuarit | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e shtëpisë së të moshuarve | Ndërtesë 2- katëshe |

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

| Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale<br>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror<br><br>Bashkia Gjirokastër<br><br>Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale | | | | | | | Identifikoi: Ing.Bujar Bundo<br>(Specialist investimesh)<br><br>Supervizoi: Edmond Kushi<br>(Shef Shërbimesh)<br><br>Aprovoi: Natasha Hodaj<br>(Drejtor i Përgjithshëm) | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. rendor** | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
| | **Zona** | **Nr.i** | **Lloji** | **Emri i pronës** | **Sip.totale** | **Nga sip.** | **Funksioni** | **Insitucioni/enti** | **Institucioni/enti** | **Të dhëna të** |

| | kadastr. &indeksi i hartës | pasurisë | i pronës | adresa | e pronës (m²) | totale sa e ndërtesës (m²) | për të cilin përdoren prona | me përgjegjësi administrative | përdorues, statusi juridik i përdorimit | tjera (shënime të veçanta) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** | **11** |
| 20 | | | Truall Ndërtesë | Godina e shtëpisë së të moshuarve Gjirokastër | 1622 | 580 | Qendër shërbimesh për të moshuarit | MPÇS Dr.Përgjithshme e shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e shtëpisë së të moshuarve | Ndërtesë 2&3 kate |

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

| Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale<br>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror<br><br>Bashkia Berat<br><br>Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale | | | | | | | Identifikoi: Ing.Bujar Bundo<br>(Specialist investimesh)<br><br>Supervizoi: Edmond Kushi<br>(Shef Shërbimesh)<br><br>Aprovoi: Natasha Hodaj<br>(Drejtor i Përgjithshëm) | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. Rendor** | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
| | **Zona kadastr. &indeksi i** | **Nr. i pasurisë** | **Lloji i pronës** | **Emri i pronës adresa** | **Sip.totale e pronës (m²)** | **Nga sip. totale Sa e** | **Funksioni për të cilin përdoret** | **Insitucioni/enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/Enti përdorues, statusi juridik i** | Të dhëna të **tjera (shënime të** |

| | hartës | | | | | ndërtesës ($m^2$) | prona | | përdorimit | veçanta) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** | 11 |
| 21 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e Qendrës së Zhvillimit Berat | 3905 | 322 | Qendër shërbimesh për PAK | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e Qendrës së Zhvillimit | Ndërtesë 2- katëshe |
| 22 | | | Ndërtesë | Godina e Zyrës Rajonale Berat | 75 | 75 | Zyrë administrative | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e Zyrës Rajonale | Kati përdhe, pallat 8- katësh |

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

| Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale<br>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror<br><br>Bashkia Vlorë<br><br>Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale | | | | | | | Identifikoi: Ing.Bujar Bundo<br>(Specialist investimesh)<br><br>Supervizoi: Edmond Kushi<br>(Shef Shërbimesh)<br><br>Aprovoi: Natasha Hodaj<br>(Drejtor i Përgjithshëm) | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. rendor** | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
| | **Zona kadastr. & indeksi i hartës** | **Nr. i pasurisë** | **Lloji i pronës** | **Emri i pronës adresa** | **Sip.totale e pronës ($m^2$)** | **Nga sip. Totale: Sa e ndërtesës ($m^2$)** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Insitucioni/enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)** |

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 23 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e Qendrës së Zhvillimit<br>Vlorë | 4350 | 690 | Qendër shërbimesh për PAK | MPÇS<br>Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e Qendrës së Zhvillimit | Ndërtesë<br>2- katëshe |
| 24 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e shtëpisë së foshnjës 0-3 vjeç<br>Vlorë | 1498 | 368 | Qendra e shërbimeve për foshnjat | MPÇS<br>Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e shtëpisë së foshnjës | Ndërtesë<br>2- katëshe |
| 25 | | | Ndërtesë | Godina e Zyrës Rajonale<br>Vlorë | 113 | 113 | Zyrë administrative | MPÇS<br>Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e Zyrës Rajonale | Kati i parë, pallat<br>8-katësh |

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

| | |
|---|---|
| Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale<br>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror<br><br>Bashkia Sarandë<br><br>Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale | Identifikoi: Ing.Bujar Bundo<br>(Specialist investimesh)<br><br>Supervizoi: Edmond Kushi<br>(Shef Shërbimesh)<br><br>Aprovoi: Natasha Hodaj<br>(Drejtor i Përgjithshëm) |

| **Nr. rendor** | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Zona kadastr. & indeksi i hartës** | **Nr. i pasurisë** | **Lloji i pronës** | **Emri i pronës adresa** | **Sip.totale e pronës ($m^2$)** | **Nga sip. totale: sa endërtesës ($m^2$)** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Insitucioni/enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/Enti përdorues,Statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)** |
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** | **11** |
| 26 | | | Truall | Godina e Qendrës | 3000 | 675 | Qendër | MPÇS | Drejtoria e | Ndërtesa |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Ndërtesë | Polivalente të Zhvillimit Sarandë | | | shërbimesh për PAK | Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Qendrës së Zhvillimit | 2 kate & 3 kate |
| 27 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e shtëpisë së fëmijëve 6-14 vjeç Sarandë | 3300 | 1240 | Qendra e shërbimeve për fëmijë | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Sociale Shtetëror | Drejtoria e shtëpisë së fëmijës | Ndërtesë<br>2 kate & 3 kate |
| 28 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Shtëpia e pushimit të fëmijëve Borsh-Sarandë | 3750 | 600 | Qendra e pushimeve për fëmijët jetimë | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e shtëpisë së fëmijës 6-14 vjeç Sarandë | Ndërtesë<br>1 kate & 2 kate |

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

Bashkia Elbasan

Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale

Identifikoi: Ing.Bujar Bundo
(Specialist investimesh)

Supervizoi: Edmond Kushi
(Shef Shërbimesh)

Aprovoi: Natasha Hodaj
(Drejtor i Përgjithshëm)

| **Nr. rendor** | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Zona kadastr. & indeksi i hartës** | **Nr. i pasurisë** | **Lloji i pronës** | **Emri i pronës adresa** | **Sip.totale e pronës ($m^2$)** | **Nga sip. totale: sa e ndërtesës ($m^2$)** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Insitucioni/enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)** |
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** | **11** |
| 29 | | | Ndërtesë | Godina e Zyrës Rajonale | 96 | 96 | Zyrë administrative | MPÇS Dr.Përgjithshme e Shërbimit | Drejtoria e zyrës rajonale | Kati përdhe pallat 5-katësh |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Social Shtetëror | | |

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

| Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale<br>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror<br><br>Bashkia Korçë<br><br>Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale | | | | | | | Identifikoi: Ing.Bujar Bundo<br>(Specialist investimesh)<br><br>Supervizoi: Edmond Kushi<br>(Shef Shërbimesh)<br><br>Aprovoi: Natasha Hodaj<br>(Drejtor i Përgjithshëm) | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. rendor** | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
| | **Zona kadastr. & indeksi i hartës** | **Nr. i pasurisë** | **Lloji i pronës** | **Emri i pronës adresa** | **Sip.totale e pronës ($m^2$)** | **Nga sip. Totale: Sa e ndërtesës ($m^2$)** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Insitucioni/enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)** |
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** | **11** |
| 30 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e Qendrës së Zhvillimit<br>Korçë | 1560 | 410 | Qendër shërbimesh për PAK | MPÇS<br>Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e Qendrës Zhvillimit | Ndërtesë<br>2- katëshe |
| 31 | | | Truall | Godina e shtëpisë | 600 | 190 | Qendër | MPÇS | Drejtoria e | Ndërtesë |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Ndërtim | së foshnjës 0-3 vjeç<br>Korçë | | | rezidenciale shërbimesh për foshnjat 0-3 vjeç | Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | shtëpisë së foshnjës | 2- katëshe |
| 32 | | | Truall<br><br>Ndërtesë | Godina e Qendrës Ditore<br>Korçë | 840 | 250 | Qendër ditore shërbimesh për PAK | MPÇS<br>Dr.Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror | Drejtoria e Qendrës Ditore | Ndërtesë<br>2- katëshe |

**VENDIM**
**Nr.414, datë 23.1.2006**

**MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË DISA SUBJEKTEVE RADIOTELEVIZIVE PRIVATE**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr.371, datë 10.11.2005 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën e subjekteve radiotelevizive që nuk kanë shlyer pagesën vjetore të licencës për vitin 2004, si më poshtë:

000/ lekë

| Nr. | Emri i subjektit | Detyrimi i pagesës vjetore të licencës |
|---|---|---|
| 1. | TV Dibra | 14.3 |
| 2. | TV Malësia | 71.5 |
| 3. | Radio Argjiropolis | 29.3 |

2. Subjektet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, janë të detyruara të ndërpresin menjëherë transmetimin.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Halil Lalaj**

**Fletorja Zyrtare gjendet**: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Për informacione më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 042 555 63; ose 04 267 468

## BOTIMET E TJERA TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE:

1. **REGJISTRAT E NOTERISË sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.**
2. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË dhe të gjitha kodet e legjislacionit shqiptar.**
3. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI të përditësuara për:**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | PROKURIMIN PUBLIK…………………………………………………………. | 1500 |
| 2. | NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005) ………………………………………… | 600 |
| 3. | SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vellimi i II-të)............... | 1500 |
| 4. | TAKSAT DHE TATIMET…(suplement 2006)…………………………..... | 1500 |

| | | |
|---|---|---|
| 1. | TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT……………………………… | 1500 |
| 2. | TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT……………………………………… | 2000 |

## DOLI NGA SHTYPI:

| | | |
|---|---|---|
| 1. | PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT……………… | 500 |
| 2. | KODI DOGANOR………………………………………………………………….... | 1000 |
| 3. | KODI DETAR ………………………………………………………………………… | 1000 |

Doli nga shtypi më 8.2.2006

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 4000 copë | Formati: 60x88/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë